

VITI 2018 TË NA SHOQËROJ ME




DEMOKRACIA, LULE E BUKUR

ALTINA (11), ALLEN (11), ARBLEND (11), ALMINA (11), AMRA (11)



Demokracia ka vlerat më të mira që mund të ekzistojnë. Këto vlera i japin dritë jetës sonë

E shihni vizatimin tonë më lart? Aty kemi vizatuar disa fëmijë. Mund të shihni se ata janë të lumtur dhe pa brenga. Kjo për shkak se ata jetojnë të lirë. Jetojnë në paqe. Jetojnë me tolerancën dhe me solidaritetin. Jetojnë duke u trajtuar të barabartë. A e dini se kush



është burimi i gjithë kësaj? Burimi i gjithë kësaj mirësie, njihet si demokraci. Demokracia është sinonim i mirësisë dhe i dashurisë. Në një botë të mbushur me demokraci nuk ka luftëra, nuk ka konflikte dhe as urrejtje. Përkundrazi.

E dini si është ndjenja kur je duke luajtur dhe papritur rrëzohesh dhe lëndon pak këmbën? Besoj na ka ndodhur të gjithëve. Mirëpo, pastaj e mjekon plagën dhe dhimbja largohet si me dorë. Këtë ndjenjë të jep demokracia. Këtë ndjenjë kemi pasur edhe ne gjatë

luftës së fundit në Kosovë. Megjithatë, më pas morëm ilaçin dhe ky ilaç ishte demokracia. Tashmë, demokracia është mburoja jonë dhe nuk lejon që ne qytetarët e saj ta përjetojmë ndonjë gjë jo të mirë.

Pas ca vitesh do të jemi gati të shkojmë në universitet. Pavarësisht gjinisë, fesë apo kombit, ne jemi të lirë të zgjedhim drejtimin që na pëlqen. Kjo sepse demokracia nuk njeht dallime. Prandaj, jemi të lirë të zgjedhim. Jemi të lirë edhe të shkojmë në shkollë, të shprehemi, të kemi familje, të votojmë, etj. Këto që i përmendëm janë të drejtat tona. Këtë formë të qeverisjes e kemi që nga viti 507 p.e.s kur për herë të parë lindi në Athinë. Atëherë ishte demokracia direkte sepse populli merrte vendimet direkt.


Kurse sot ne në Kosovë, kemi demokracinë përfaqësuese sepse zgjedhim përfaqësuesit tanë. Kjo është demokracia jonë. Lulja më e bukur dhe dhurata më e ëmbël. Ta ruajmë që ta kemi gjithmonë.



Sot, gazetarë të demokracisë

ZGJEDHJET NA RRETHOJNË NGADO

AMER (11), MELISA (11), DRENI (11), ZEHRA (11), AMINA (11)



Të nderuar lexues të gazetës sonë, ne sot kemi vendosur të shkruajmë për një temë shumë të dashur për ne. Kjo temë është „Zgjedhjet në Kosovë“. Neve do të na pëlqente shumë nëse ju do të lexonit këtë artikull

Unë jam Ameri dhe dua t'iu tregoj se si kam zgjedhur në jetën e përditshme. Para dy javëve, jemi mbledhur e gjithë familja dhe kemi biseduar se ku do t'i kalojmë disa ditë të pushimit. Prindërit e mi më pyetën mua dhe unë isha në pozitë të vendosja për të gjithë familjen. Dëshira ime ishte të shkonim për disa ditë në Brezovicë dhe të merrnim pak ajër të pastër. Të tjerëve iu pëlqeu shumë ideja ime dhe të nesërmen u nisëm për në Brezovicë. Aty u kënaqëm shumë.

Unë jam Zehra dhe me juve dua të ndaj një ngjarje ku edhe unë kam zgjedhur. Gjatë këtij viti shkollor, në lëndën e matematikës kemi pasur një test vlerësues. Në njërin nga detyrat e dhëna, nuk isha e sigurt në cilën mënyrë ta zgjidh këtë detyrë. Në fund, detyrën e parashtruar vendosa ta zgjidh në mënyrën më të lehtë dhe më të thjeshtë për mua.

Ndërsa, unë jam Melisa, anëtarja tjetër e grupit tonë. Nesër është dita e fundit e shkollës për gjysmëvjetorin e parë. Që do të thotë se nga e hëna tjetër do të fillojnë pushimet dimërore. Për këto pushime, mua dhe familjes sime na duhet të vendosim ku duam t'i kalojmë ato. Ne kishim dy alternativa, prej të cilave ne duhet të zgjedhim vetëm njërin prej tyre. Dy alternati-

vat ishin të shkonim për skijim në Brezovicë ose të shkonim të qëndronim tek gjyshja ime për disa ditë. Mua më pëlqeu më shumë të shkonim për skijim. Prandaj, këtë dëshirë timen ua tregova pjesës tjetër të familjes. Ata u pajtuan me mua, kështu që ne do të shkojmë nga e hëna në Brezovicë për të skijuar. Shpresojmë se aty do të kalojmë mirë.

Për fund, unë jam Dreni. Edhe mua më ka rënë rasti të zgjedh më parë. Kur isha në klasën e IV-të kam pasur një dilemë. Mua më është dashur të zgjedh në mes të sportit të basketbollit dhe atë të futbollit, si sporte ku do të trajnohesha. Pasi mendova për një kohë, unë kam zgjedhur basketbollin. Ne jemi fëmijë, por ashtu siç e patë, bëjmë zgjedhje për çdo ditë. Madje, kur të arrijmë moshën e duhur, moshën 18 vjeçare, ne do të mund të bëhemi pjesë e zgjedhjeve shtetërore. Këto zgjedhje janë të rëndësishme, andaj iu ftoj më të gjithë juve të votoni.



Gazetarët shkruajnë për zgjedhjet

KUVENDI KUJDESET PËR MIRËQENIEN TONË

AMINA (12), DANIS (11), AMRA (11), ELLZA (11), SEZER (11)



Kuvendi është institucioni më i rëndësishëm në jetën tonë si qytetarë. E çka e bën kaq të rëndësishëm, vazhdojeni leximin e artikullit

Shkolla është institucioni pa të cilin qytetarët nuk do të mund të zhvilloheshin jo vetëm intelektualisht. E ardhmja e vendit do të ishte shumë më ndryshe pa praninë e këtij institucioni. Aty ne edukohemi dhe përgatitemi për të ardhmen tonë dhe të vendit. Mësojmë për histori, kulturë, ambient, shkencë, etj. Pra, me një fjalë, shkolla është shtëpia e dijes. Përpos këtyre që i cekëm, ne mendojmë që është e domosdoshme të tregojmë se në këto institucione të gjithë nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë. Shkolla jonë është shembulli më i mirë për të kuptuar atë që sapo e përmendëm. Në shkollën tonë afro 750 nxënës vijnë në mësimin. Jo të gjithë këta nxënës janë të komunitetit shqiptar. Kemi edhe nxënës të cilët i përkasin komunitetit boshnjak.

„A trajtohen të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë?“ Mund të pyet ndonjëri nga ju të dashur lexues. Po, në shkollën tonë edhe pse nxënësit nuk janë vetëm të një komuniteti, prapëseprapë ata trajtohen si shumica, si ne. Në të njëjtën mënyrë trajtohen edhe deputetët të cilët punojnë në Kuvend. Edhe ata janë të etnive të ndryshme. Mirëpo, kjo nuk i bën të dallohen. E tërë kjo vjen si rezultat i sistemit të udhëheqjes së vendit tonë, e që është demokracia. Arsyeja pse filluam artikullin me shkollën dhe pastaj e lidhëm me Kuvendin është sepse për ne dhe për shumicën e qyte-

tarëve, këto dy institucione janë më të dashurat. Pa to do të ishte shumë e vështirë të arrijmë qëllimet tona. Së pari, po të mos ishte Kuvendi që të miratonte ligjet për shkollën ne sot nuk do të ishim këtu. Ndoshta do të ishim duke bërë diçka tjetër, por jo diçka me vlerë kaq të madhe sa shkolla. Ky institucion na mëson sot, në mënyrë që në të ardhmen të jemi mjaftueshëm të përgatitur, qoftë për punë, qoftë për jetë.

Por, ky nuk është ligji i vetëm që ka miratuar Kuvendi e që ka ndikim direkt në jetën tonë. Me ndikim të njëjtë dhe rëndësi të madhe është edhe ligji për familje. Nga të gjithë ata që ne njohim dhe kemi dëgjuar për ta, nuk na ka rastisur asnjëherë të dëgjojmë se ka qytetarë të cilët nuk duan të kenë familje apo nuk i duan familjet e tyre. Qytetarët duan të kenë familje. Për atë edhe e respektojnë ligjin për familje. Këto ligje që i përmendëm sa e sa herë, miratohen nga deputetët, qëllimi i të cilave është mirëqenia e qytetarëve.



Gazetarët e lumtur


Pasi që pjesë e demokracisë është edhe bashkëpunimi dhe solidariteti, në këtë faqe të gazetës do të keni mundësinë që të shihni dhe lexoni punën e të tre grupeve së bashku. Ky bashkëpunim për ne është shumë i rëndësishëm. Ashtu siç edhe e kemi mësuar, të qenurit bashkëpunues dhe solidar është ndjenja më e bukur që një qytetar mund ta ndiej. Kështu siç ishim ne sot, iu urojmë edhe ju të dashur lexues të jeni gjatë gjithë jetës suaj

Në artikullin e parë nuk kemi dashur që menjëherë të flasim për Kuvendin. Ajo çka ne bëmë ishte të fillojmë me shkollën dhe familjen si dy gjërat më të bukura, e pastaj të kalojmë tek Kuvendi. Kështu, mund t'ia kuptojmë vlerën më mirë. Po të mos funksiononte mirë Kuvendi, asnjërin prej atyre që i cekëm më lart nuk do t'i gëzonim.

Për këtë, tash duam t'iu njoftojmë edhe me punën që bën ky institucion, pa të cilin nuk do të dëshironim kurrë të funksiononte vendi ynë. Kuvendi është i vetmi institucion shtetëror që zgjedhet direkt nga qytetarët. Personat që punojnë në Kuvend janë përfaqësues të popullit. Prandaj, themi se Kuvendi ka funksion për-

faqësues. Gjithsej janë 120 deputetë të cilët mendojnë dhe punojnë për të mirën e afro 1.8 milion banorëve. Janë të zgjedhurit e popullit, prandaj populli i mirëpret dhe i respekton ligjet që miratohen nga ana e tyre. Miratimi i ligjeve njihet si funksioni legjislativ i Kuvendit. Por, përpos që miratojnë ligje, dhe përfaqësojnë popullin në Kuvend, ata po ashtu sigurohen që ligjet që miratohen të zbatohen. Për këtë arsye, e kontrollojnë punën e Qeverisë. E ky funksion i Kuvendit, njihet si funksioni kontrollues.

Kuvendi është institucioni më i dashur për ne. Ky institucion ndikon në jetën tonë dhe e përmirëson atë. Mos harroni të jeni qytetarë sa më demokratikë.



Këtu kemi paraqitur disa nga ligjet e Kuvendit si: ligji i arsimit, që të gjithë qytetarët pa dallime kanë të drejtë të arsimohen. Ligji për votim, çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare fiton të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Si dhe në vizatimin e fundit kemi paraqitur ligjin për libra falas gjatë arsimit fillor



Në fund na mbetët t'iu urojmë secilit prej jush të dashur lexues vit të mbarë, e përzemërsisht e falenderojmë Kuvendin për punën dhe të mirat e shumta që bën për ne



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ekrem Rexha“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa:VI-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Lubizhdë, Prizren